

# BOTA

## > Nga "Muri" tek heqja e lotarisë, propozimi

### i Donald Trump për emigracionin


Në fjalimin drejtuar Kombit, Presidenti amerikan Donald Trump e bëri të qartë se do të vazhdojë përparrë me ashpësimin e rregullave për emigracionin. Përmes zëdhënës së Shtëpisë së Bardhë njoftoi më herët katër shtyllat kryesore të propozimit të Trump. "Mbrotja e kufirit, përfshirë ndërtimin e murit me Meksikën, dhënia e statutit të rregullt për emigrantë të paligjshëm të sjellë në moshë të mitur, shfuqizimi i ligjve o lejojnë emigracion të zjeguar familial, si dhe eliminimi i lotarisë Green Card për të kaluar në një sistem të bazuar tek meritati e aplikantëve" tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Kirsten Nielsen.

Nga dhënia e statutit të rregullt për emigrantët që kanë hyrë në SHBA në moshë të mitur pritet të përfitojnë rreth 2 milione vjetë. Por, nisma e shefit të Shtëpisë së Bardhë ka një pengesë madhore; Kongresin. Ishin pikërisht mosmarrëveshjet për politikat e emigracionit që një javë më parë shkaktuan ngërçin dhe bllokimin e Qeverisë për tri ditë. Diskutimet mes republikanëve dhe demokratëve në Kongres vijojnë, ndërsa nga Shtëpia e Bardhë nisma mbrohet me fanatizëm. "Këto ndryshime jo vetëm që do të përmirësonin sigurinë, por edhe do të na ndihmojnë të vlerësojmë më mirë refugiatët e ligjshëm, që i shpëtojnë persekitimit", deklaroi sekretarja për Sigurinë Kombëtare Kirsten Nielsen.

**RASTI  
"BURNS  
STRIDER"**

## > Apologjia e Clinton: Duhej ta kisha shkarkuar!

Hillary Clinton e pranoi se duhej ta kishte shkarkuar gjatë fushatës këshilltarin e saj, Burns Strider, të akuzuar për ngacmimë seksuale. Ish-kandidatja demokrate për Shtëpinë e Bardhë, sot ndien këqardhje e është përpjekur të shpjegojë përsë zgjodhi t'i jepte 52-vjetarit një mundësi të dytë. "E bëra sepse nuk mendova që pezullimi do të ishte zgjidhja e duhur", shkroi ajo në Facebook, vetëm pak minuta përparrë se Donald Trump të mbante fjalimin e tij të pare drejtuar kombit. Në vend të kësaj, Clinton e detyroi të ndiqte seanca terapië, i shkurtoi pagën dhe nuk e lejoi të



punonte më me vartësen e tij, që e akuzonte për abuzime.

"Besova atëherë se ndëshkimi ishte mjafueshëm i rreptë dhe se do ta merrte fort e qartë mesazhin tim", shkruan ish-Sekretarja e Shitetit. Raporte të shumta tregojnë se, një sërë zyrtarësh të fushatës, përfshirë menaxheren Solis Doyle, e kishin rekomanduar me forcë pe-

zullimin e Striderit. Ai vet nuk i ka mohuar publikisht akuzat e lëshuar kundër tij. Ndërkohë, momenti kohor i zgjedhur nga Clintoni për të postuar deklaratën ka shkaktuar polemika të shumta, duke nxitur spekulimet se është përpjekur në këtë mënyrë "të varroste" apologjinë e saj mes stuhisë mediatike që do të shkaktonte fjalimi i Trumpit.

# Pasojat ekonomike ndërkombëtare të Donald Trump

Ajo që ka ndryshuar në mënyrë themelore me administratën e Trump nuk është se ajo sillet në mënyrë më egoiste se sa administratat paraardhëse, por se kjo aktualja duket se nuk është e bindur se sistemi global i shërbën interesave strategjike të SHBA-së. Për pjesën tjetër të botës, pyetja kyçë është nëse sistemi botëror është mjafueshëm i fortë për t'i mbijetuar tërheqjes së vendit që e krijoj atë.

Nga Jean Pisani-Ferry

Forumi Ekonomik Botëror i Davosit i këtij viti rezultoi mundësia e radhës për Presidentin e SHBA-së Do-

nald Trump dhe administratën e tij

që të shpalosë mungesën e vetëpërmbytjes verbale dhe për të shkaktuar valë tronditëse në të gjithë ekonominë botërore. Këtë herë pati dy burime tronditjeje. Tronditja e parë erdhë nga Sekretari i Thesarit të SHBA-së Steven Mnuchin, i cili theu më shumë se dy dekada disipline të ashpër duke sugjeruar se një dollar më i dobët është në interes të Amerikës. E dyta erdhë nga Sekretari i Tregtisë Wilbur Ross, i cili duket se u gëzua nga perspektiva e shpalljes dhe fitores së një lufte tregtare. Së paku në këtë rast, ishte vetë Trump që riktheu qetësinë duke mohuar se SHBA po ndjek një strategji lufte tregtare në kurriz të fqinjëve. Por ai e bëri këtë vetëm pasi deklarata e sekretarëve të kabinetit të tij patën tërhequr reagime të ashpra nga partnerët ndërkombëtarë. Nëse viti i parë i Trump në pushtet ofron ndonjë indikacion se çfarë pritet të ndodhë më vonë, ka pak arsyë për të pritur një udhëheqësi ekonomike amerikane më të qëndrueshme. Një vit pas inagurimit, Davosi ofroi një rikujtesë së fuqishme se ai është larg të qenit i normalizuar.

Që të jemi të drejtë, administrata e Trump natyrish nuk është e para e tillë që e vë "Amerikën të parën." Për shkak të sistemit politik që shëh nga brenda dhe persistencës së rrymave izolacioniste, SHBA ka qenë vazhdimisht më ngurrues se sa vendet Europiane për të hyrë në apo për t'u bindur angazhimeve ndërkombëtare. Refuzimi më 1948 i Kapitullit të Havanës (një përpjekje e hershme për të krijuar një organizatë globale të tregtisë), arrimësia nga kongresi ndaj institucioneve të Breton Uds, apo refuzimi i Presidentit George W. Bush për të ratifikuar Protokollin e Kiotos mbi ndryshimet klimaterike janë thjeshtë disa nga shembujt e shumtë. Në mënyrë të ngjashme, marrja e masave të pamëshirshme në mbrojtje të interesave të SHVA-së nuk ka nisur me Trump. Presidenti Richard Nixon me vendimin e njëanshëm të vitit 1971 për të braktisur standardin e arit solli një goditje të madhe ndaj sistemit monetar ndërkombëtar. Eksperimenti monetarist i Rezervës Federale të SHBA në fund

  
**REPUBLIC OF ALBANIA**  
**MUNICIPALITY OF KORÇA**

**INVITATION FOR BID**

**Project KORCA FOOD HUB:  
Sustainable Rural  
Development through  
Regional Branding ",  
Ref. Nr. IADSA/2017/05**

Korca Municipality, in the frame work of the project "KORCA FOOD HUB: Sustainable Rural Development through Regional Branding", Ref. Nr. IADSA/2017/05, "invites all the interested parties to submit their offers for the activity 3.3 Rehabilitation works funded by the Italian-Albanian Debt for Development Swap Program (IADSA). Executing entity, address, telephone number : Bashkia Korçë, address: Rr.28 Nentori, Korçë Albania , tel +35582243353 Available fund is 33,559,990 ALL, including VAT. Interested companies may withdraw the tender specifications/documents, at the Municipality of Korca, Second Floor, Office No. 12, at Public Procurement Office. The deadline for submitting offers is on 05 March 2018 ,time 12:00 Municipality of Korca, Archive and Protocol Office. The offers submitted after the deadline will not be accepted. The offers will be opened by the Bid Evaluation Commission on 05 March 2018 , time 12:00 Municipality of Korca, Second Floor, Meeting Hall. The Authorized representatives of the bidders are invited to attend the opening of offers.